



MINISTERO
DELL'INTERNO

INFORMACION PËR PËLQIMIN E INFORMUAR PËR TË KRYER TESTIN PËR HIV

HIV (Human Immunodeficiency Virus - Virusi i mungesës së imunitetit të njeriut) është virusi që shkakton AIDS-in (Acquired Immune Deficiency Syndrome - Sindroma e mungesës së imunitetit të fituar), një sëmundje infektive që e sulmon dhe e komprometon rëndë mbrojtjen e organizmit tonë, duke vënë në rrezik jetën nëse nuk trajtohet. Një person që infektohet me HIV bëhet sieropozitiv dhe mund t'ua transmetojë infeksionin njerëzve të tjerë. Të gjithë mund të infektohen me HIV.

HIV transmetohet kryesisht nëpërmjet marrëdhënieve seksuale të pambrojtura me personat me HIV, nëpërmjet gjakut (për shembull nëpërmjet gjilpërave të përdorura nga personat me HIV), ose nga një nënë me HIV tek fëmija e saj gjatë shtatzënisë, në momentin e lindjes ose nëpërmjet ushqyerjes me gji.

ÇFARË ËSHTË TESTI. E vetmja mënyrë për të ditur nëse jeni infektuar me HIV është të bëni një test që përbëhet nga një mostër normale gjaku që, kur analizohet, diagnostikon praninë ose jo të infeksionit HIV. Testi ndahet në dy nivele: një test i nivelit I, që pasohet, në rast të një rezultati pozitiv ose të dyshimtë, nga një test i nivelit II ose konfirmimi, i vetmi që mund të japë sigurinë e plotë të rezultatit. Testi përdoret për të zbuluar praninë e antitropave anti-HIV në gjak, që zhvillohen vetëm nëse personi që bën testin ka rënë në kontakt me virusin.

Rezultati i testit është:

-pozitiv nëse konstatohet prania e antitropave kundër virusit (sieropozitiviteti HIV),

-negativ kur në gjak nuk ka gjurmë antitropash (sieronegativiteti HIV).

Periudha e formimit të antitropave anti-HIV mund të ndryshojë nga një minimum prej disa javësh deri në 6 muaj pas kontaktit me virusin. Testi HIV kontrollon vetëm praninë ose jo të antitropave ndaj virusit, por nuk jep asnjë informacion për gjendjen shëndetësore dhe sistemin imunitar.

TESTI ËSHTË VULLNETAR. Askush nuk mund t'i nënshtrohet, pa pëlqimin e tij, analizave që synojnë konstatimin e infektimit me HIV, përveçse për arsye të nevojës klinike në interes të tij.

Është e rëndësishme të dini se një diagnozë e hershme mund të lejojë një zgjedhje më të gjerë të trajtimit.

MBROJTJA E ANONIMITETIT DHE KONFIDENCIALITETIT

Testi për HIV është falas dhe mund të kërkohet që të kryhet në mënyrë anonime, në çdo rast garantohet mbrojtja maksimale e privatësisë dhe sekretit profesional, edhe për personat e huaj pa leje qëndrimi. Komunikimi i rezultatit të testit HIV mund t'i jepet ekskluzivisht personit që iu nënshtrova marrjes së gjakut (Ligji 135 i 5 qershorit 1990). Ligji në fuqi mbron nga diskriminimi që rrjedh nga testimi pozitiv për HIV dhe u siguron që të gjithë njerëzve, italianë dhe të huaj, terapitë e mundshme të nevojshme.

SHPREHJA DHE MARRJA E PËLQIMIT TË INFORMUAR

për kryerjen e analizës diagnostike që synon konstatimin e infeksionit HIV

Sipas dhe për efektet e Dekretit Legjislativ n. 196/2003, pas informimit, të dhënat mbledhen me qëllimin e vetëm të pëlqimit të informuar. Ato i nënshtrohen sekretit profesional dhe nuk do t'i komunikohen askujt, por mbahen ekskluzivisht brenda strukturës ku është kryer testimi.

I/E nënshkruari/a (mbiemri e emri)

lindur

më

Përfaqësues legal i
provues)

(bashkëlidhet dokumentacioni

Pasi mora informacion të kuptueshëm dhe shterues për procedurën e aktit shëndetësor që më propozohet, shpreh lirisht, spontanisht dhe me vetëdije pëlqimin tim për kryerjen e analizave diagnostike që synojnë konstatimin e infeksionit HIV.

[] **E PRANOJ** marrjen e gjakut [] **NUK E PRANOJ** marrjen e gjakut

Data ____ / ____ / ____ Firma _____

Konfirmoj se dhashë, nëpërmjet një bashkëbisedimi, informacion të detajuar për kontrollin dhe besoj se është kuptuar nga i/e interesuari/a.

Firma e operatorit shëndetësor
që mori pëlqimin